



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN050820210001

Tiranë, më 13.10.2021

Komisioni 47

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ” sh.a.

Nr. NIPT-i: K42101801N

Adresa e selisë: Yrshek, Kashar, Autostrada Tiranë – Durrës km 9

Personi përgjegjës Skerdi Drenova

Për të zhvilluar projektin: “**Ndërtim i Linjës së Transmetimit 400 KV Shqipëri - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafë Thanë)**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 20. Ndërtimi i linjave elektrike në lartësi, me një voltazh mbi 220 kV dhe gjatësi mbi 10 kilometra.

Vendndodhja: Fier - Elbasan - Qafe Thanë, zonat kadastrale 2703, 3827, 3445, 3021, 2696, 2448, 1527, 1967, 3843, 3000, 2265, 2374, 3250, 1515, 3003, 3504

Të dhëna teknike:

Sipërfaqja në shfrytëzim: 49 864 m²

Gjatësi: 130 km

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:

- Sugjerojmë që të gjitha mbetjet e gjeneruara të menaxhohen në përputhje me bazën ligjore, duke marrë në konsideratë:

-VKM nr.575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;

-Ligjin nr. 10 463, datë 22.9. 2011 ”Për menaxhimin e integruar te mbetjeve”, të ndryshuar; - VKM nr. 418, datë 27.05.2020 “Dokument i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit te Mbetjeve”.

- Sugjerojmë të respektohen kriteret e akteve nënligjore në fushën e biodiversitetit dhe legjislacionit si më poshtë vijon:

Ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar;

• Ligjin nr 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar.

- Raporti jep informacion shumë të përgjithshëm për biodiversitetin. Ky përshkrim duhet të jetë specifik për gjurmën e zhvillimit dhe zonën e ndikimit, në vend që të jetë një përshkrim i gjerë dhe i përgjithësuar i mjedisit më të gjerë. Gjithashtu, nuk janë referuar si duhet burimet e të dhënave dhe të informacionit për mjedisin ekzistues dhe mungojnë të dhënat për lloje të rrezikuara apo me vlera ekonomiko-mjekësore.

- Raporti duhet të kishte marrë parasysh alternativa të tjera në lidhje me projektin, si për vendin e zhvillimit ashtu edhe për modifikimet e mundshme në faza të ndryshme të tij. Një vlerësim i duhur i alternativave përfshin përshkrimin e tyre, paraqitjen e pasojave të tyre mjedisore, dhe një shpjegim të arsyeve për pranimin ose refuzimin e tyre.

- Rekomandojmë sigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në rast emergjencash dhe zvogëlim në burim të zhurmës, duke përdorur aparatura dhe mjete në kushte të mira teknike. Të tregohet kujdes në venddepozitimin e materialit të gërryer apo mbetjeve të tjera shtesë me ndikim në biodiversitet.

- Në procesin e mbjelljes së durëve/shkurreve gjatë rehabilitimit, rekomandojmë që të përdoren lloje vendase si: Bli (Tilia sp.), Ilqe (Quercus ilex), Gështenjë kali (Aesculus hippocastanum), Lofatë (Cercis siliquastrum), Boshtër (Forsythia aeuropaea), Shqopë (Erica arborea), Fshikarthë (Colutea arborescens), Leandër (Nerium oleander), etj. Të shmanget mbjellja e llojeve të huaja (aliene) të cilat nuk u shërbejnë llojeve vendase të faunës (kafshëve, shpendëve, insekteve, etj.) për ushqim dhe strehim, apo bëhen problematike për llojet e tjera bimore, si: Acacia dealbata,

Acacia saligna, Acer negundo, Robinia pseudoacacia, Lantana camara, Oenothera speciosa, Albizia julibrissin, Amorpha fruticosa, Broussonetia papyrifera, Eucalyptus camaldulensis, Melia azederach, Mirabilis jalapa, Parthenocissus quinquefolia, Eisteria sinensis, Yucca aloifolia, Ardisia elliptica, Cecropia peltata, Fallopia japonica, Hiptage benghalensis, Pueraria montana, Leucaena leucocephala, Melaleuca quinquenervia, Prosopis glandulosa, Mimosa pigra, Cinchona pubescens, Schinus terebinthifolius, Myrica faya, etj.

- Sipërfaqja që do të zënë shtyllat e linjës së transmetimit 400kV është minimale dhe nuk pritet të ndikoj në habitatet natyrore dhe cilësinë apo gjendjen e mjedisit

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier-Vlorë-Gjirokastrë: jep mendimin e saj pozitiv në lidhje me Praktikën me sugjerime:

-Do të duhet të bëhet menaxhimi i mbetjeve inerte nëpërmjet shërbimit të Bashkive repektive ku do të kalojë linja. Dherat e gjeneruara gjatë fazës së germimit duhet të ripërdoren sërish për qëllime mbushjeje, në rast të kundërt do të duhet të sistemohen sipas legjislacionit në fuqi, një ndër të cilat është edhe VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedisin tokë do të duhet të ruhet vegetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim;

- Automjetet e transportit duhet të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në vëndet ku linja kalon në zonat e banuara dhe në zonat që lidhen me subjektin;

Të ruhet perimetri i sigurisë nga zona ku do të kalojë linja e transmetimit.

- Në pjesën ku kalimi i linjës prek pronë private të bëhet kompensimi sipas legjislacionit në fuqi.

-Të gjitha shtyllat elektrike duhet të kenë numrin e tyre në përputhje me kriterin e rendin e miratuar si dhe të instalohen tabela sinjalizuese të rrezikut në një lartësi të paktën 2 metra.

-Të punohet me orare të reduktuara gjatë shtrimit të linjës së transmetimit të tensionit të lartë në zonat e urbanizuara për shkak të nivelit të zhurmave dhe shtimit të trafikut.

-Rruga e linjës duhet të ketë një distancë sigurie prej 21 m në secilën anë (ose 25 m në secilën anë nga boshti i linjës së transmetimit) nga receptorët e ndjeshëm siç janë shtëpitë /pronat e banimit ,aty ku është e mundur në masën më të madhe të mundshme që do të lejohen nga dizajni i projektit

Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat- Elbasan- Korçë: jep mendimin e saj pozitiv në lidhje me Praktikën,por duhet të marrë parasysh edhe disa kushte të sugjeruara:

-Lagia e ambienteve dhe makinave me uje per shmangien e pluhurave sidomos gjate kohes se thate dhe me ere.

-Kontrolli i makinerive për ndonje avari te mundshme dhe rrjedhje aksidentale.

-Kujdes maksimal gjate punimeve per ndonje rrjedhje dhe ndotje pranë burimeve ujore në zonë.

-Marrjen e masave të mbrojtjes kundër zjarrit dhe pajisjen me sistemin e ujit dhe fikëseve të zjarrit në rast të ndonjë aksidenti të mundshem.

-Punonjësit të jenë të pajisur me veshje përkatëse dhe masat mbrojtëse gjatë gjithë operimit te punes.

-Të merren masat për shmangien e rrjedhjeve të pakontrolluara të lëngjeve ndotëse

-Te punohet ne orare te caktuara dhe jot e behen shqetesim per banoret perreth me zhurmat e makinerive

Bashkia Dimal shprehet për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore duke zbatuar kushtet e mëposhteme

- Mirëmenaxhimin e mbetjeve që lajohen gjatë zbatimit të projektit, sipas kuadrit ligjor perkares
- Mirëmenaxhimin e zhurmave që krijohen gjatë zbatimit të projektit, sipas kuadrit ligjor ne fuqi

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se:

Referuar projektit në formatin DWG, disa pjesë të linjës prekin në territore të zonave të mbrojtura dhe konkretisht:

- Segmenti i linjës E68-E71, rreth 400 metër gjatësi, kalon në RNM “Kuturman”.
 - Segmenti (E 145-E148), rreth 500 metër kalon në PM “Liqeni i Pogradecit”, në zonën e zhvillimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZZHT/Q)
 - Pika FE 10, ndodhet 90 metër larg monumentit natyror (MN) "Ujvarat e Siqeces",
 - Pika FE 10 është 90 metër larg Monumentit "Ujvarat e Siqecës", shpallur me VKM-në nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumentave të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Për këtë kërkojmë të spostohet deri në 200 m largësi siç e kërkon ligji. Gjithashtu duke qënë se shtrirja e Linjës së Transmetimit 400 KV prek pjesërisht në disa segmente të saj në zonë të mbrojtur (RNM dhe PM si më lartë), kërkojmë nga OST-së që të mundësojë shmangjen (largimin) e gjurmës së linjës në segmentet që prekin, duke i nxjerrë jashtë kufirit të zonave të mbrojtura. Kjo edhe për shkakun se nuk kemi të bëjmë me gjatësi të mëdha.
- ✓ Duke qënë se ndikimi është i papërfillshëm dhe kryerja e këtij investimi është me rëndësi ekonomike për vendin, pasi do të shtrihet edhe në shtetin fqinj duke ndikuar pozitivisht në përmirësimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në rajon, shprehemi dakort me kushtet e mësipërme.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun:

Konsultimi me publikun u zhvillua, me dt 21.07.2021 ora 12:40. Morën pjesë përfaqësues i shoqërisë “Doko” Sh.p.k. –, përfaqësues nga dy Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashkise-Roskovec-Patos-Dimal-Belesh), përfaqësues nga studio mjedisore, përfaqësues të OST-s., përfaqësues të Konsulentit dhe. - Banorë të zonave në afërsi të zonës ku është projektuar të zhvillohet projekti, Kundërshtim nuk kishte nga asnjë nga banorët, sepse edhe ata ishin mjaft të informuar përsa i përket aktivitetit të shoqërisë, që nuk ndikonte aspak, si nga ana e zhurmave dhe pluhurave, mëqenëse zonat e banuara kanë një largësi të konsiderueshme nga zona e punimeve. Gjithashtu u bënë pyetje nga përfaqësues të bashkive pjesëmarrëse dhe nga përfaqësues të ARM Fier dhe Roskovec, nëqoftëse ky projekt do të ndikonte në zona të mbrojtura, por u theksua që projekti “Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi- Maqedoni e Veriut, nuk prek asnjë zonë të mbrojtur

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

- **Shkresa Nr. 2806 Prot, datë: 26.04.2021 nga Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), me objekt “Ndërtim i Linjës së Transmetimit 400 KV Shqipëri - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafë Thanë)”. " Loti 1.**
- **Në mendimin e Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.**

4. **Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**
 - 4.1 **Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
 - 4.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
 - 4.3 Aktiviteti të kryhet brenda sipërfaqes së lejuar.
 - 4.4 **Bazuar në mendimin e AKZM, duke qenë se sipërfaqja e kërkuar ndodhet në kufi të zones së mbrojtur (MN) "Ujvarat e Siqeces", shpallur me VKM-në nr. 303, datë 10.05.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumentave të natyrës Shqiptare", kategoria e III e zonave të mbrojtura, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, kërkojmë nga OST-së të spostohet deri në 200 m largësi siç e kërkon ligji, Gjithashtu të mundësojë shmangien (largimin) e gjurmës së linjës në segmentet që prekin, në zonë të mbrojtur (RNM dhe PM), duke i nxjerrë jashtë kufirit të zonave të mbrojtura. Kjo edhe për shkakun se nuk kemi të bëjmë me gjatësi të mëdha**
 - 4.5 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e **Ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", Neni 17-Monument Natyre (Kategoria III)** nga zbatuesit e projektit të zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore, të merren masa që mos të dëmtohen formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik i zones.
 - 4.6 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.7 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.8 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.9 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.10 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.11 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.12 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.13 Të sistemohen brenda sipërfaqes së ndërhyrjes të gjitha sterilet e gjeneruara nga gërmimet.
- 4.14 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.

- 4.15 Të shfrytëzohen sa më shumë të jetë e mundur rrugë ekzistuese, me qëllim që ndërhyrja në sipërfaqen e gjelber të jetë sa më e vogël.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Niveli I zhurmave gjatë procesit të jetë brënda normave të lejuara 60DB – 80DB dhe të punohet në orare kur shqetësimi I banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.20 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.21 Kompania duhet të respektojë gjithashtu rekomandimet e vendosura në raportin e VNM-së si dhe të zbatojë të gjitha parimet e Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.22 Të hartohet Plani i Përballimit të Emergjencave i plotë dhe i detajuar, para vendosjes në funksionim të veprës dhe të raportohet pranë AKM-së për përbajtjen e këtij planit.
- 4.23 Të trajnohen të gjithë punonjësit dhe të njihen me termat e Planit të Përballimit të Emergjencave
- 4.24 **Të bëhet rehabilitimi i zonës ku kryhen punimet, në mënyrë periodike, duke e kryer atë pas cdo segmenti ku është kryer ndërhyrja.**
- 4.25 Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Vendimit, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-se një relacion shkresorë në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).
- 4.26 Në përfundim të punimeve subjekti të dorëzojë pranë AKM-së, një relacion ku të pasqyrohen edhe me foto, të gjitha punimet rehabilituese të territorit përreth.

4.27 Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.

- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona në hyrje të kantierit	55	45	14.04.2022	Çdo 6 muaj
Kantier ndërtimi	55	45	14.04.2022	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban më i afert me kantierin	55	45	14.04.2022	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedisi” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2,5})	20-25 µg/m ³	14.04.2022	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ 40 µg/m ³	14.04.2022	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-

në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Miratoi:

Aneksi 1. Harta me koordinatat



Koordinatat (X,Y) - Gauss Kruger:

(4377936.54, 4508062.55)	(4382245.79, 4504583.66)
(4377974.96, 4507940.07)	(4382519.38, 4504338.66)
(4377998.37, 4507865.43)	(4383052.15, 4504263.00)
(4378301.28, 4507665.06)	(4383433.48, 4504208.83)
(4378558.49, 4507606.10)	(4383953.48, 4504134.99)
(4378978.24, 4507509.88)	(4384508.14, 4504056.22)
(4379309.53, 4507213.20)	(4384899.37, 4504000.66)
(4379644.89, 4506912.87)	(4385241.08, 4503952.13)
(4379935.53, 4506652.58)	(4385815.55, 4503870.55)
(4380125.58, 4506482.39)	(4386276.12, 4503805.14)
(4380300.71, 4506325.56)	(4386612.88, 4503757.32)
(4380639.79, 4506021.90)	(4387048.98, 4503695.39)
(4380814.93, 4505865.05)	(4387349.55, 4503737.66)
(4381273.25, 4505454.61)	(4387605.92, 4504078.46)
(4381552.71, 4505204.34)	(4458094.4, 4550356.1)